REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

KARTA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

KARTA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Karta e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, hartohet në zbatim të nenit 12 e 14 të Ligjit nr.114 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"*(i ndryshuar),* të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016 *(i ndryshuar)* si dhe akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

1. Objekti i kartës së auditimit të brendshëm :

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokument zyrtar i cili përcakton: Statusin organizativ të njësisë së auditimit të brendshëm, qëllimin, misionin, objektivat e punës, pavarësinë dhe rregullimet ligjore që sigurojnë pavarësinë; përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm, autoritetin e auditimit të brendshëm; përgjegjshmërinë, linjat e raportimit të drejtuesit të njësisë dhe Standardet e praktikave të auditimit, të përcaktuara në Standardet ndërkombëtare për praktikat profesionale të kësaj veprimtarie.

Ky dokument përforcon pozicionin e veprimtarisë audituese të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Lushnje, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësisë së auditimit të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, prona dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm.

Karta e Auditimit është një akt administrative që miratohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

- **Statusi organizativ i njësisë së auditimit të brendshëm;**

Auditimi i Brendshëm është i organizuar si sektor, në varësi të drejtëpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë Lushnje. i përbërë nga 3 punonjës, 1 Përgjegjësi dhe 2 specialistë. Struktura dhe organizimi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm miratohet me Urdhër te Kryetarit të Bashkise, si pjesë përbërëse e strukturës organizative të Bashkise Lushnje.

- **Qëllimi i Auditimit të Brendshëm;**

Qëllimi i auditimit të brendshëm është të japë siguri objektive, të pavarur dhe të ofroj këshillim për menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i Brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit dhe të qeverisjes.

2. Misioni:

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për Titullarin, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Kryerja e cdo angazhim auditimi në përputhje me aktet ligjore nënligjore në fuqi, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të planit strategjik e vjetor të miratuar, të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Lushnje.

Auditimi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre me anë të analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve e rekomandimeve lidhur me veprimet e ekzaminuara.

3. Objekti i Punës dhe veprimtaria e Auditimit të Brendshëm:

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të kryhet duke respektuar përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikat Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuara për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Këto udhëzues, përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe performancës së veprimtarisë audituese. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do t'i përmbahet edhe politikave, procedurave metodave të auditimit, si pjesë e manualit Standard të auditimit të brendshëm.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në Bashkine Lushnje:

✓ mbulon me auditim të gjitha programet, proceset dhe veprimtarinë e drejtorive të bashkise së bashku me subjektet e varësisë;

✓ Përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e aktiviteteve, operacioneve, proçeseve, proçedurave dhe sistemeve në drejtoritë e bashkisë dhe në njësitë e varësisë për të siguruar :

a) Besueshmëri dhe integritet te informacionit financiar dhe operacional;
b) Pajtueshmëri me politikat, planet, proçedurat, ligjet dhe rregullat;
c) Ruajtje te aktiveve;
d) Përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe efiçence të burimeve;
e) Përmbushje te objektivave dhe qëllimeve të vendosura në lidhje me veprimtaritë ose programet e bashkise si njësi publike;

✓ zhvillohet në mënyrë të planifikuar bazuar në Planin Vjetor të Auditimit dhe në Programin e Angazhimit të Auditimit, të hartuar për çdo strukture apo te gjitha nivelet e bashkise (njesise publike) qe auditohen.

Objekti i punës i Sektorit të Auditit të Brendshëm Bashkia Lushnje është që të përcaktojë nëse sistemet e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes funksionojnë ne atë menyrë që garantojnë se:

- ✓ risqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur.
- ✓ informacioni kryesor financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë.
- ✓ veprimet e punonjësve janë në përputhje me politikat, standardet, procedurat, ligjet, aktet nenligjore ne zbatim te tyre dhe rregulloret e brendshme.
- ✓ burimet, fondet buxhetore dhe te ardhurat e krijuara nga subjektet administrohen me ekonomi, efiçencë dhe perdoren në mënyrë të përshtatshme.
- ✓ realizohen programet, planet dhe objektivat e organizates dhe njesive vartese .
- ✓ cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm i performances janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm.
- ✓ çështjet e rëndësishme ligjore që kanë impakt ne institucion janë pranuar dhe adresuar si duhet.

4. Autoriteti

Drejtuesi i njësisë dhe stafi i auditimit janë të autorizuar, për të patur akses të plotë, të lirë dhe të pakufizuar tek të gjitha funksionet, regjistrat, pronat dhe personeli për kryerjen e çdo angazhim auditimi me përgjegjësi në ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit. Të gjithë punonjësve, pjesë e njësive publike duhet t'u kërkohet bashkëpunim për të ndihmuar njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e misionit, rolit dhe përgjegjësive të saj. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të ketë akses të lirë dhe të pakufizuar edhe tek Bordet.

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

➢ **Kufizimet:**

Drejtuesi i sektorit të auditimit dhe audituesit nuk janë të autorizuar:

- të kryejnë detyra operative për bashkinë ose institucionet në varësi të bashkisë;
- të mbajnë një mandat politik apo të jenë zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike;
- të krijojnë ose miratojnë transaksione të llogarisë, etj., që janë jashtë Njësisë së Auditimit të Brendshëm;
- të drejtojnë veprimtaritë e punonjësve, që nuk janë punësuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, përveçse kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar audituesit e brendshëm.
- të auditojnë veprime ose operacione, për të cilat kanë qënë të punësuar dhe përgjegjës ne 3 vitet e fundit në njësinë që auditohet, me përjashtim të funksionit të audituesit të brendshëm.
- Të ushtrojnë cdo veprimtari ose punë me pagesë apo të kenë përfitime të tjera të natyrave dhe formave, që krijojnë gjendje konflikti interesash me ushtrimin e auditimit, me përjashtim të mësimdhënies dhe publikimit , sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nënpunësit civil.

5. Organizimi

Drejtuesi i Sektorit të Auditimit do të raportojë tek Kryetari i Bashkisë, i cili do të miratojë:

a) Kartën e auditimit të brendshëm;
b) Planin vjetor dhe strategjik të auditimit të brendshëm;
c) Buxhetin dhe burimet e auditimit;
d) Performancën e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm dhe çështje të tjera;
e) Vendime në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit të njësisë së auditimit;
f) Kryerjen e veprimeve me natyrë investiguese, mbi veprimtaritë e rëndësishme brenda Bashkise dhe njesive te varesise, të dyshuara për mashtrim, dhe për këtë drejtuesi të njoftojë menaxhimin.

6. Pavarësia dhe objektiviteti

Veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të jetë e lirë nga ndërhyrjet në lidhje me çështjet e zgjedhjes së auditimit, fushëveprimin, procedurat, frekuencën, kohën, apo përmbajtjen e raportit, të cilat lejojnë mbajtjen e një qëndrimi të nevojshëm të pavarur dhe objektiv. Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe audituesit e brendshëm duhet të jenë objektiv në përmbushjen e detyrave të tyre.

Pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënia e gjykimeve objektive gjatë kryerjes së auditimeve.

Objektiviteti kërkon që audituesit të bazojnë gjykimin dhe punën e tyre në informacionin faktik dhe të paanshëm. Interesi apo këndvështrimi personal nuk duhet të ndikojnë në veprimtarinë audituese.

Integriteti: Parimi i Integritetit nënkupron ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë audituese.

Njësia e auditimit të Brendshëm është e pavarur nga pikëpamja funksionale dhe organizative.

- *Pavarësia Organizative*, Sektori i Auditimit të Brendshëm si pjesë e strukturës organizative të Bashkisë Lushnje, raporton direkt tek Kryetari i Bashkisë, i cili është niveli më i lartë i drejtimit. Sektori i Auditimit të Brendshëm, nuk angazhohet në kryerjen e

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

funksioneve dhe veprimtarive të tjera brenda bashkisë të cilat nuk lidhen me funksionimin e auditimit të brendshëm, pasi nuk është pjesë e strukturave operacionale të Bashkisë Lushnje.

- *Pavarësia Funksionale,* Sektori i Auditimit të Brendshëm kryen në mënyrë të pavarur planifikimin, kryerjen e auditimit, raportimin e rezultateve dhe rekomandimeve. Kryerja e auditimit zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator, standardeve Ndërkombëtare të miratuara nga Ministri i Financave dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë bashkisë. Audituesit respektojnë strukturat në njësinë që auditohet, rregullat e etikës dhe sjelljes në administratën publike.

Audituesit e brendshëm duhet të tregojnë se janë të pavarur dhe objektivë duke plotësuar Deklaratën e Konfliktit të Interesit të Audituesit. Mund të ketë një sërë rastesh ku risku mund të jetë real ose perceptohet se pavarësia e audituesit të brendshëm është në rrezik. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm ka përgjegjësinë për të përcaktuar se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për të administruar dhe ruajtur pavarësinë e audituesit të brendshëm.

7. Përgjegjësitë e Aktorëve

Përcaktimi i sistemeve/fushave që do të mbulohen me auditim duhet të jetë gjithëpërfshirës për të mundësuar ekzaminimin efektiv dhe të rregullt të të gjithë veprimtarive operacionale, financiare dhe të lidhura, por nuk mund të jetë subjekt i ndonjë kufizimi brenda subjektit publik . Për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara të njësisë publike vlerësohet përshtatshmëria dhe efektiviteti i qeverisjes, rrezikut të menaxhimit të njësisë dhe kontrolleve të brendshme, si dhe cilësia e performancës për kryerjen e përgjegjësive të caktuara .

Kjo përfshin:

a) Vlerësimin e ekspozimit ndaj riskut në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të njësisë.
b) Vlerësimin e besueshmërisë dhe integritetin e informacionit dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar, dhe për të raportuar një informacion të tillë.
c) Vlerësimin e sistemeve të vendosura për të siguruar përputhjen me politikat, planet, procedurat, ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm në njësinë publike.
d) Vlerësimin e mjeteve dhe ruajtjen e pasurisë verifikimin e ekzistencës së aktiveve të tilla.
e) Vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetin me të cilën burimet janë përdorur. f)Vlerësimin e operacioneve apo programeve për të vërtetuar nëse rezultatet janë në përputhje me objektivat e vendosura, dhe nëse operacionet ose programet janë duke u kryer sipas parashikimeve.
f) Monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të qeverisjes.
g) Monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut të njësisë publike.
h) Vlerësimin e cilësisë së performancës së audituesve të brendshëm pjesë e grupit të auditimit të marrë nga jashtë NjAB-së.
i) Kryerjen e konsultimit dhe shërbimeve këshilluese në lidhje me qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe kontrollin, si objektiva të përshtatshme për njësinë.
j) Raportimin periodik për veprimtarinë e auditimit të brendshëm lidhur me qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe të performancës, në lidhje me planin e tij. 30
k) Raportimin e rëndësishëm që ekspozimi ndaj riskut dhe çështjet e kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga njësia, janë adresuar saktë.

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

l) Vlerësimin e përshtatshmërisë së operacioneve të veçanta me kërkesë të këshillit mbikëqyrës / këshillit administrativ ose të menaxhimit.

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për:

a) Organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm dhe hartimin e Kartës së Auditimit sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.
b) Hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë;
c) Miratimin e raporteve të angazhimeve të auditimit të brendshëm, pas konsultimit me njësinë publike të audituar për gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat i dorëzohen për përdorim të brendshëm titullarit të njësisë publike.
d) Përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.
e) Raportimin menjëherë në formë të shkruar tek titullari i njësisë publike dhe te ministri përgjegjës për financat, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e njësisë së auditimit përbëjnë vepër penale.

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm janë:

a) Të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm;
b) Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
c) Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
d) Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
e) Të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
f) Të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit.
g) T'i japin rekomandime për strukturen/njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritje;
h) të raportojnë menjëherë tek drejtuesi i njësisë së auditimit kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale.

8. Plani i Auditimit të Brendshëm

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm pas konsultimit me Kryetarin e Bashkisë, çdo vit, do t'i paraqesë Kryetarit të Bashkisë një plan auditimi të brendshëm për shqyrtim dhe miratim. Plani i auditimit të brendshëm jep një informacion mbi punën që do të kryejë njësia e auditimit gjatë një viti, dhe përfshin kërkesat për buxhetin dhe burimet që do të përdoren gjatë vitit të ardhshëm kalendarik.

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Bashkisë, i cili ka të drejtë të përcaktojë përgjegjësinë individuale ndaj personave të ngarkuar drejtpërsëdrejti me zbatimin e rekomandimeve.
Drejtuesi i NJAB mund ti dërgojë menaxhimit periodikisht shkresa rikujtesë për rekomandimet e pazbatuara. Të gjitha gjetjet e rëndësishme do të mbahen në një skedar si çështje të hapura derisa ato të zbatohen plotësisht.
Njësia e Auditimit përgatit një raport vjetor mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, ky raport së bashku me pasqyrat përkatëse i dërgohet DHAB pranë Ministrisë së Financave.

10. Sigurimi i cilësisë dhe program i përmisimit:

Sektori i Auditimit të Brendshëm do të mbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit që mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm, i cili miratohet me urdhër të titullarit të MEPJ-së. Programi do të përfshijë një vlerësim të konformitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm me përkufizimin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve dhe një vlerësim nëse audituesit e brendshëm zbatojnë Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim. Drejtuesi i DAB-së komunikon me Titullarin dhe Komitetin e Auditimit, lidhur me implementimin e programit dhe sigurimin e cilësisë, duke përfshirë rezultatet e vlerësimet e vazhdueshme të brendshme dhe vlerësime të jashtme, të cilat duhet të kryhen të paktën një herë në çdo 5 vjet.

11. Standardet dhe metodologjia e auditimit të brendshëm.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me:

a) Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit përgjegjës për financat;
b) Ligjit nr.114 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik";
c) Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, Manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit.

12. Hyrja në fuqi e Kartës së Auditimit.

Kjo Kartë do të shqyrtohet dhe rishikohet sa herë lind nevoja mbi bazë të propozimeve të Drejtuesit të njësisë së AB. Çdo ndryshim do të miratohet zyrtarisht nga Kryetari i Bashkise.
Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

Sektori i Auditimit

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com